

VENDIM
Nr. 47, datë 2.4.2024

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË
NIVELIN E TENSIONIT 20/10/6 KV, PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.4.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 739/1 prot., datë 29.3.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, për vitin 2024”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” (FSHU) sh.a., me shkresën nr. 1246 prot., datë 29.2.2024, protokolluar me tonën me nr. 739 prot., datë 4.3.2024, ka paraqitur kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin janar 2024, për klientët FMF të lidhur në nivelet e tensionit 6/10/20 kV (klientë të rëndësisë së veçantë) që kanë dalë në treg të liberalizuar nga data 1 janar 2022.

- Rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike për këtë kategori klientësh, i përlogaritur dhe i propozuar për miratim nga vetë shoqëria është 18.39 lekë/kwh. Në këtë çmim FSHU sh.a. ka përfshirë gjithashtu dhe zërin e kostove të disbalancave me arsyetimin e dhënë në vijim: “Duke qenë se sipas nenit 8, të ‘Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit’, miratuar me vendimin nr. 201, datë 4.12.2017, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, në çmimin e përlogaritur nuk parashikohen kostot e disbalancave, kërkojmë reflektimin e kësaj kostoje në çmimin e muajit janar 2024”.

- ERE, me shkresën nr. 738/1 prot., datë 21.3.2024, ka sjellë në vëmendjen e shoqërisë FSHU sh.a. se: bazuar në nenin 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenin 7, pika 1, të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin nr. 201/2017, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar, çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga FMF-ja duhet të përfshijë vetëm kostot e identifikuar nga furnizuesi, sipas përcaktimeve të kësaj metodologjie.

- Referuar VKM-së nr. 456/2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji”, të ndryshuar, në nenin 5, pika 2, ndër të tjera përcaktohet se: “Furnizuesit të Shërbimit Universal, për të përmbushur kërkesat e klientëve që përfitojnë nga Shërbimi Universal i Furnizimit, në përputhje me parashikimet e pikës 1, të nenit 109, të ligjit nr. 43/2015, ‘Për sektorin e energjisë elektrike’, të ndryshuar, i vendoset detyrimi i shërbimit publik për të blerë sasinë e nevojshme të energjisë elektrike, të prodhuar nga Shoqëria e Prodhimit të Energjisë Elektrike, aksionet e së cilës kontrollohen nga shteti (Shoqëria Publike e Prodhimit)”.

- FSHU sh.a., në aplikimin fillestar, të përcjellë me shkresën nr. 1246 prot., datë 29.2.2024, protokolluar me tonën me nr. 739 prot., datë 4.3.2024, ka bashkëlidhur gjithashtu korrespondencën e shoqërisë KESH sh.a. me nr. 457/1 prot., datë 19.2.2024, në të cilën sikurse parashikuar edhe në VKM-n nr. 456/2022, të ndryshuar, evidentohet se, KESH sh.a., në bazë të analizave për Programin Ekonomik Financiar të vitit 2024 dhe parashikimeve të periudhës 2025–2028, ka paraqitur në Këshillin

Mbikëqyrës projeksionet e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë, për të cilat ky i fundit, nëpërmjet vendimit nr. 03, datë 26.1.2024, miratoi programin ekonomik-financiar të shoqërisë për vitin 2024 dhe parashikimin për vitet 2025–2028.

- Referuar të dhënave të korrespondencave të sipërcituara, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar për blerjen e energjisë elektrike për klientët FMF të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, për vitin 2024, do të jetë 12.00 lekë/kwh.

- FSHU sh.a., në shkresën nr. 1245/2 prot., datë 27.3.2024, duke risjellë në vëmendje korrespondencën e sipërcituar të shoqërisë KESH sh.a., kërkon që për shkak se kostot e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së kësaj kategorie klientësh mbeten konstante përgjatë gjithë vitit 2024, të miratohet çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga FMF-ja për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV (klientë të rëndësishëm të veçantë) për vitin 2024.

- Në vijim, mbështetur në “Metodologjinë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, paraqesim përllogaritjen e kryer për përcaktimin e çmimit FMF për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV. Komponentët e marrë në konsideratë janë:

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike, për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kwh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelet e tensionit 20/10/6 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 365, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”, vijon të jetë 3.99 lekë/kwh.

- Kostot administrative, të cilat në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 366, datë 15.12.2023, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022”, vijnë të jenë 1.06 lekë/kwh.

Në zbatim të metodologjisë së sipërcituar, si dhe bazuar në të dhënat e aplikimit, nga përllogaritja e kryer nga ERE, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, është si në tabelën e paraqitur më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për Vitin 2024			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	12.00
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.36
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh	18.26

Mbështetur në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimet e shoqërisë, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, për vitin 2024, do të jetë 18.26 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për periudhën 1.1.2024–31.12.2024, prej 18.26 lekë/kwh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Çdo ndryshim në elementet përbërëse të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola Sadushi